

**RAPORTET  
PARLAMENT – QEVERI  
NE NJE SISTEM  
DEMOKRATIK**






# Tempulli i Demokracisë

---

*Demokracia realizohet përmes:*

*Parlamenteve të fortë,  
Zgjedhjeve të lira dhe të drejta,  
Mbrojtjes të të drejtave të njeriut,  
Barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit,  
Shoqërisë civile aktive,  
Partive politike efikase  
Mediave të pavarura*




# Tempulli i Demokracisë

---

*Një parlament nuk garanton demokracinë, por nuk mund të ketë demokraci pa parlament.*

*Parlamenti është një institucion i demokracisë që mundëson ballafaqimin e ideve dhe opinioneve të ndryshme.*

*Parlamenti moderon tensionet duke ruajtur një ekuilibër midis kërkesave të kundërta për shkak të diversitetit dhe bën të mundur përfaqësimin e këtij diversiteti.*




# Tempulli i Demokracisë

---

*Nuk mund të ekzistojë një model i vetëm i  
parlamenteve demokratike*

*Çdo parlament është produkt i historisë dhe kulturës  
së vendit të tij*

*Ndërsa nuk ekziston një recetë magjike për ndërtimin  
e një parlamenti demokratik, një konsensus  
ndërkombëtar ka nisur të shfaqet, në lidhje me  
kriteret për vlerësimin e parlamenteve demokratike*




# Tempulli i Demokracisë

---

*Përtej veçorive të një parlamenti nacional, që të konsiderohet demokratik, parlamenti duhet të plotësojë disa kriterë të rëndësishme:*

- Të jetë përfaqësues.*
- Të jetë transparent.*
- Të jetë i arritshëm nga publiku.*
- Të jap llogari.*
- Të jetë efikas.*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Demokracitë e sotme parlamentare karakterizohen nga mënyra se si vendimmarrja politike ndahet midis parlamentit dhe qeverisë.*

*Megjithëse funksionet e tyre konturohen në Kushtetutën e çdo vendi, realiteti është më shumë një ndërveprim midis tyre.*

*Kufiri ndarës midis pushteteve është mjaft poroz dhe shpesh ekuilibri relativ midis këtyre dy pushteteve është i vështirë të vendoset.*



# Raportet Parlament - Qeveri

---


*Parlament apo Qeveri e fortë?*

*Ekulibri si në një “enë komunikuese”:*

*Rënia e parlamentit = Sundim i qeverisë*

*“Parlament i fortë” do të thotë të ketë pushtetin e duhur:*

- *Pushteti si kapacitet: të disponosh të drejtat juridike dhe burimet (financiare, njerëzore dhe organizuese) për të përmbushur funksionet kushtetuese.*
- *Pushteti si marrëdhënie: të disponosh në mënyrë të mjaftueshme pushtetin dhe pavarësinë për të kontrolluar me efikasitet veprimtarinë e ekzekutivit.*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Progresi i demokratizimit nuk është aq shumë i varur nga tipi i sistemit kushtetues sesa nga pushteti dhe efikasiteti i trupës së tij ligjvënëse.*

*«Forca e pushtetit legjislativ është njëri nga çelësat, madje çelësi institucional i demokratizimit...». Në regjimet që karakterizohen nga një trupë e dobët ligjvënëse, forcimi i saj duhet të jetë si prioritet i parë.*






# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Demokracia atrofizohet në mënyrë thelbësore kur ekzekutivi mbisundon në mënyrë të tepruar në raport me parlamentin. Në këtë rast duket se parlamenti ekziston vetëm për të "vulosur" vendimet e ekzekutivit.*

*Shteti me një parlament që i mungon kapaciteti për të kontrolluar ekzekutivin ose për të ndikuar në politikat e tij, nuk mund të mendohet demokratik në kuptimin e sotëm.*



# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Brënda kuadrit kushtetues të një vendi,  
në ekuilibrin e raporteve Parlament – Qeveri  
ndikojnë:*

*I. Faktorët politikë,*

*II. Faktorët strukturorë dhe proçedurial*



# Raportet Parlament - Qeveri


---

*I. Faktorët politikë lidhen kryesisht me problematikën e sistemit zgjedhor dhe atë të sistemit partiak:*

*së pari, nga raportet midis drejtuesve të qeverisë dhe të opozitës;*

*së dyti, nga raportet ndërmjet drejtuesve të partive dhe parlamentarëve përkatës;*

*së treti, nga raportet midis partive brënda koalicionit.*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Roli i shumicës qeverisëse në parlament është të shndërrojë në ligj politikat e qeverisë.*

*Roli i opozitës në parlament është të kundërshtojë legjislacionin e paraqitur nga qeveria duke paraqitur përparësitë e saj alternative, ose një mënyrë të ndryshme të trajtimit të çështjeve që debatohen.*

*Opozita e mirë duhet të përpiqet të jetë konstruktive. Kjo do të thotë të kundërshtojë vetëm atë legjislacion që bie ndesh qartazi me politikat e opozitës.*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Drejtuesit e shumicës dhe të opozitës konsultohen me deputetët e tyre për të arritur konsensuset e nevojshme.*

*Ata përpiqen të ushtrojnë pushtetin e tyre për të bindur deputetët kundërshtarë dhe në shumicën e rasteve ia arrijnë qëllimit, por nuk mungojnë rastet që ata të votojnë kundër vijës së partisë.*

*Grupet parlamentare janë vendi ku deputetët mund të ndikojnë në politikat ose legjislacionin e propozuar*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Sfida e qeverive të koalicionit është administrimi korrekt i raporteve ndërmjet partive në koalicion, që shpesh kanë programe dhe prioritete të ndryshme.*

*Kur koalicionet janë të ngushta numerikisht, partitë e vogla përpiqen të përfitojnë maksimalisht, edhe nëpërmjet presioneve.*

*Si rregull këto raporte rregullohen me "Marrëveshjen e koalicionit".*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

II. *Faktorët strukturore dhe procedural që ndikojnë në ekuilibrin e raporteve parlament – qeveri janë:*

- Rendi i ditës,*
- Procesi ligjvënës,*
- Procesi buxhetor,*
- Procesi i kontrollit parlamentar*



# Raportet Parlament - Qeveri

---

## Rendi i ditës:


*Caktimi i rendit të ditës është pjesë thelbësore e autonomisë parlamentare.*

*Prej kohësh është sanksionuar prioriteti qeveritar në përcaktimin e rendit të ditës së parlamentit, nëpërmjet të cilit qeveria dominon axhendën e parlamentit.*

*Në një parlament përfaqësues absolutizimi i prioritetit të qeverisë çon në mosrespektimin e nismave të opozitës.*

*Duhet që të jenë të qarta dhe pa ekuivoke si "statusi" i qeverisë", ashtu dhe "statusi i opozitës".*





# Raportet Parlament - Qeveri


---

## Procesi ligjvënës:

*Përsa i përket nismës për ligje të reja, në shumicën e parlamenteve demokratike, është qeveria që mbisundon.*

*E drejta e amendamentit është një nga parimet bazë të parlamentarizmit.*

*Shpesh, të mbështetura nga shumica, vendosen rregulla kufizuese. Këto rregulla duhet të ndikojnë më shumë në disiplinimin e procesit se sa në kufizimin e nismës së parlamentarëve për amendamente. Kjo përbën një "terren të rrëshqitshëm".*



# Raportet Parlament - Qeveri


---

## Proçesi i buxhetit:

*Buxheti është fushë e ekzekutivit.*

*Mbisundimi i ekzekutivit në fushën e buxhetit mund të neutralizohet nga ana e parlamentit vetëm nëpërmjet ushtrimit të një procesi sistematik të kontrollit të zbatimit të buxhetit,*

*Autonomia e parlamentit në fushën e buxhetit është e lidhur me përcaktimin e buxhetit të tij si dhe me kontrollin e zbatimit.*



# Raportet Parlament - Qeveri


---

## Kontrolli i Qeverisë:

*është funksioni më i rëndësishëm i çdo parlamenti që duhet të kryhet si nga shumica qeverisëse, ashtu dhe nga opozita.*

*Ndërsa deputetët e opozitës janë plotësisht të motivuar të ushtrojnë atributet e kontrollit, nuk është e njëjta gjë për ata të shumicës qeverisëse. Shumica qeveritare predominohet nga besnikëria partiake.*

*Disiplina e shumicës parlamentare dhe forca e opozitës vlerësohet me votimin e besimit*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Parlamentet mund të ushtrojnë mënyra të ndryshme të kontrollit mbi qeverinë, mbi ministra të veçante, mbi politikat publike, etj*

*Kontrrolli i parlamentit ndaj qeverisë nuk duhet të shprehet thjesht si kundërvënie antagomiste, apo thjesht si bllokim i qeverisë. Një qasje e tillë negative, sidomos kur është e pamotivuar, ka pasoja negative për vetë parlamentin dhe për vet opozitën*




# Raportet Parlament - Qeveri

---

*Parlamenti është vendi i përfaqësimit politik ku alternativat qeverisëse transformojnë preferencat në vendime përmes politikave publike.*

*Parlamenti është vendi ku një shumicë mbështet qeverinë, dhe një opozitë kritike, që kontrollon, që propozon, që kandidon për të zëvendësuar qeverinë.*

*Ky është ekuilibri i pushteteve legjislativ- ekzekutiv që duhet të garantoj një parlament demokratik.*



# Raportet Parlament - Qeveri

---

*EkUILIBRI relativ i pushteteve legjislativ-ekzekutiv është një dinamikë në evoluim të vazhduar, që ulet apo ngrihet me ndryshimin e zhvillimeve politike.*

*Kjo është arsyeja pse parlamentet demokratike, sidomos ato të vendeve në tranzicion demokratik, nëpërmjet reformave synojnë të vendosin baraspeshën e duhur të pushteteve, në mënyrë që sistemi demokratik të jetë funksional.*

FUND

